



Historia në shërbim të drejtësisë

Prof.Dr.Marcel Courthiade

Mund të vëmë re një **denigrim** të përgjithshëm të Historisë, i cili ka filluar para 50 viteve e vazhdon në mjaft qarqe. Nga ana tjetër, **të gjithë filozofët** që nga lashtësia e deri më sot kanë pohuar vazhdimisht se "ai që nuk e di nga vjen, as nuk është në gjendje të përgatitet për të ardhmen". Këtë kanë thënë natyrisht edhe historianët, por mund të kemi dyshim se mos mbrojnë ata punën e vetë, bukën e gojës, kurse për filozofët, nuk mund të supozojmë një arsye të tillë. **Atëherë nga vjen kjo prirje** denigruese për historinë e si justifikohet? Për mua është e qartë se autoritetet, të cilët nga prapaskena e hedhin poshtë Historinë, **kanë frikë që njerëzit e shtypur**, qoftë si popuj, qoftë si kombe, qoftë si klasë shoqërore ose profesionale, qoftë si individë ose grup, **të nxjerrin nga Historia mësimin**, që me luftë ose formë tjetër **lëvizjeje a organizimi** mund të përmirësohet gjendja e tyre, të arrihet më shumë barazi në një sistem që i shfrytëzon e shfrytëzuesit të humbasin privilegjet e tyre. Ai që nuk ka haber për historinë, **nuk di as për sukseset e lëvizjeve që kanë prurë** përparim në të kaluarën e mund të ç'motivohet mjaft kollaj nga çdo sulm kundër shfrytëzuesit apo veprim tjetër për t'u çliruar nga shtypja.

Natyrisht, shfrytëzuesit nuk e paraqesin arsyen e denigrimit në këtë mënyrë. Në radhë të parë, servirin **një argument gjoja pragmatik** "ç'na duhet? ç'na hyn në xhep?", që është një justifikim tepër trivial e populist, prej injorantësh në kufi me debilitetin, të mos themi hajvanllëkun. Në qoftë aspiratat njerëzore i ngushtojmë tek ajo që na hyn në gojë, në xhep ose në ndonjë vend tjetër, është e qartë se mbetemi në nivelin e gjësë së gjallë.

Për njerëzit, **që mendojnë sadopak më lart**, është farkuar një argument tjetër, dmth se historia **qenka e rrezikshme e gjoja mund ta kërcënojë paqen**, kur bie në duart e nacionalistëve. **Edhe kjo qëndron si parim**. Është e vërtet që historia, por edhe gjeografia, janë përdorur e ende përdoren, për të justifikuar luftëra të ndryshme, zaptimin e tokave të te tjerëve, vrasje e krime, nën parullën e njohur demagogjike **"atë të të tjerëve nuk e kërkojmë, tanin nuk e japim"**. I vetmi problem është se të dy palët rrallëherë janë dakord për çfarë është yni e çfarë është i të tjerëve...

Megjithatë, dënimi i historisë **për arsye se gjoja mund të çojë** në pasojë të rrezikshme nuk qëndron, pasi **nuk ka shkencë apo instrument të krijuar nga njeriu, që të mos rrezikojë**, të çojë në pasojë me zarar, në rast keqpërdorimi të tij. Edhe dashuria mund të ketë pasojë të rrezikshme, por nuk është një arsye për ta denigruar. **Mjafton që të hiqet dorë nga keqpërdorimi në fjalë, të luftohet ai**, pa nevojë që të hidhet poshtë vlera e vërtetuara e shkencave historike.

Përkundrazi, njohja e mirë e historisë na mundëson që të zbërthejmë mekanizmat e saj, pasi intrigat politike e së kaluarës nuk diferencohen shumë nga ato që vëzhgojmë sot e kësaj dite e mund të mësojmë shumë prej saj. Njerëzit gjithnjë kanë qenë të njëjtët brenda për brenda shpirtit të tyre, vetëm shoqëritë kanë ndryshuar nën faktorë të ndryshëm, duke qenë qoftë më të përparuara, qoftë më të prapambetura. Edhe sot shoqëritë nuk janë të barabarta, prapambetje ekziston, megjithëse egalitarizmi ideologjik politikisht korrekt trajton këtë pikë vështrimi si racist. Në fakt, racizmi nuk është që të konstatohet pabarazinë e kulturave, një gjë që bie në sy secilit që del sadopak nga zyra e tij e qarkullon nëpër vendbanimet e ndryshme të botës. Jo, racizmi është ose të pretendosh që kulturat janë të ngurta në pabarazinë e tyre e nuk mund të evoluojnë (domethënë duke akredituar që varen nga disa elemente të trashëguar), ose të shpallësh që kultura jote është më e mirë, vetëm sepse kështu të duket sipas kriterëve që ke sajuar vetë, ti ose kombi apo tarafi yt, nga pikëpamja jote kulturore. Nuk mund të pretendojmë *a priori* as se kultura moderne qenka më e mira në historinë e njerëzimit, se ndoshta disa kultura të zhdukura kanë qenë më njerëzore sesa bota jonë.

Historia jo vetëm është interesante e tërheqëse si lëndë, si njohuri, e prandaj jo rrallë është përdorur për romane apo telenovele (si histori-spektakël), por të mëson gabimet e së kaluarës, në mënyrë që të mos ripërsëriten prandaj historia ishte e quajtur "shkenca e mbretërve". Historia të shpjegon edhe si janë arritur situatat e sotme, duke përfshirë edhe padrejtësitë që paraqesin. Është rasti i Egjiptianëve, të cilët në mënyrë të pamohueshme vuajnë nga përbuzja, dallimi e diskriminimi i mazhorancës, është rasti po ashtu edhe i Romëve. Historia pra na zbulon çfarë mekanizma kanë çuar deri në këtë situatë kaq të dhimbshme duke sugjeruar mjete për të dalë prej saj. Na jep edhe fakte historikë të dobishëm për të rimëkëmbur dinjitetin e minoriteteve në fjalë e për të përcaktuar vendin e rolin e tyre në sistemin shumëkombësh evropian.

Asnjëri nuk mund të mohojë se në Evropën e sotme sundon një pabarazi e dukshme midis kombeve që e përbëjnë për sa u përket mundësive të tyre për jetë dinjitoze, për zhvillim ekonomik, për kujdesshmëri shëndetësore, për vetëvendosje, për siguri të brendshme e të jashtme etj... Nuk mund të krahasohet situata e Danimarkës me atë të Maqedonisë. Por situata është ende më e pavolitshme kur bëhet fjalë për minoritetet e sidomos popullsitë pa territor kompakt. Cila janë ato?

Në kohën e Jugosllavisë etno-entitetet ndaheshin, sipas modelit stalinjan në kombe, kombësi e grupe ose pakice etnike, *ιάδιαι, ιαδιαιίνδè è αοιè+εά αδιόια*. Në qoftë se e marrim çështjen nga pak më lart, duke e shikuar tokën nga perspektiva e Siriusit, mund të propozojmë një klasifikim të thjeshtë praktik.

1. kombet që e kanë krijuar shtetin e vet - që herët si Franca ose Anglia, ose më vonë në sh. XIX (Italia, Gjermania, Greqia, Polonia, Rumania e ngushtë etj.), në fillim të sh. XX (Rumania e gjerë, Hungaria, Shqipëria, Finlanda, Turqia etj.) ose në fund të sh. XX (Sllovenia, Sllovakia, Lituania, e pak më vonë Kosova duke qenë që kemi këtu një komb në dy shtete etj...);

2. minoritete kombëtare që jetojnë jashtë shtetit të formuar në bazë të kombit të vet (Hungarezët e Rumanisë, Sllovenët e Austrisë, Serbët e Kosovës, Danezët e Shlesvig-Holshtajnit, Suedezët e Finlandës etj...);

3. minoritete që nuk kanë shtet të vet e jetojnë në një ose dy shtete fqinj (Galicianët e Spanjës, Sorbët e Gjermanisë, Baskët e Katalanët në Francë e Spanjë etj.);

4. minoritete gjuhësore puntuale për sa i përket shtrirjes së tyre gjeografike (mund të shtrihen në një, dy ose disa fshatra; është rasti për shembull i Goranëve ose të Zhupanëve në malet Sharr, i Kajnasëve afër Korçës, i Triesenbergëve në Lihtenshtajn, i Vörëve në Estoni etj.);

5. minoritete kulturore ose historike pa ndonjë gjuhë të veçantë (Torbeshët, Shkretët ose Yörükët e Maqedonisë, Sarakacanët e Greqisë, Quinquis në Spanjë etj.);

6. diaspora që kanë një tokë prejardhjeje por janë shpërndarë në shumë vende, megjithëse mbajnë lidhje me "mëmedheun" (diaspora e shqiptarëve në Itali Arbëreshët, në Turqi, në Siri e deri në Egjipt e Amerikë si edhe diaspora Kosovare, diaspora poloneze kudo në botë, diaspora greke etj. Le të përmendim se 95% e kombit irlandez jeton në diasporë, dmth jashtë Irlandës ka 8 herë më shumë Irlandezë në ShBA sesa në Irlandë);

7. e më në fund **etno-entitetet (ose popujtë) pa territor kompakt**, të cilët karakterizohen nga dy trajta kryesore:

- *jetojnë në një mënyrë të shpërndarë* (të ngulur ose lëvizëse) në të paktën tre vende (sepse në qoftë se janë më pak vende, mund të jenë mbetja e një populli, i cili ka qenë dikur kompakt)
- *ata identifikohen si me Shtetin*, të cilit janë nënshtetas, si rregull janë edhe të lidhur fort me personalitetin e tij, po ashtu edhe me bashkësinë përtej kufijve, të cilës janë pjesë. Duhet nënvizuar se lidhjet e tyre për Shtetin ku jetojnë nuk janë vetëm formale por edhe emocionale, prej një natyre sado pak e ndryshme nga lidhjet për etno-entitetin e tyre por zakonisht jo më pak të ngushta e të sqarta. Fatkeqësisht mazhoranca zakonisht konsideron se ata janë më pak patriotë sesa "shumica etnike" një paragjykim pa bazë: pse vallë do ta donte më pak atdheun një minoritari i tillë sesa një anëtar i mazhorancës, kur ata janë rritur bashkë, kanë ndarë bashkë traditat, kulturën, ushqimin, peizazhet et këtij atdheu ?

Dallohen nga diasporat sepse ata nuk kanë mbajtur historikisht lidhje me territorin e prejardhjes lidhjet janë shkëputur. Me diasporën, ose të paktën me shumicën e tyre, ndajnë edhe një tipar tjetër: egzistencën e një "gjëme themeluese".

Në fakt, lista e mësipërme është shumë e thjeshtësuar, mbasi janë edhe raste që ndajnë tipare të dy ose më shumë kategorive, siç është gjithmonë rasti në shkencat humane, por nuk është vendi tani për ta zbërthyer këtë çështje në detaje. Me rëndësi është fakti se kategoritë në fjalë nuk janë të ngurta e një popull mund të ndërrojë profilin e vet gjatë historisë, për shembull në nivelin e gjuhës, Irlandezët janë kthyer në sh. XX në një popull pa territor kompakt me shkrirjen e gjuhës së tyre, po ashtu edhe Okcitanasët.

Gjatë gjysmë shekullit të fundit, Evropa ka përparuar shumë, pjesërisht në ndikimin e ish-Jugosllavisë e të procesit të Helsinkit, në mënyrën e trajtimit të larmishmerisë etnike brenda shteteve. Shtetet përcaktohen tani si "shtet i banuesve të tij", pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, kurse më përpara lidhja midis shtetit e etnisë mazhoritare ishte një aksiomë esencial. Ndarja më vonë midis nënshtetësisë (citizenship) e përkatësisë etnike (nationality) ka favorizuar pranimin e larmishmerisë etno-kulturore e gjuhësore si dhe një integrim më të mirë midis qytetarëve me origjinë të ndryshme etnike, por me një vizion të përbashkët në shërbim të vendit të tyre.

Në Evropë njihen sot 10 etno-entitete pa territor kompakt (pa llogaritur Yörükët, sepse janë vetëm dy ose tre fshatra në Maqedoni, afër Koçanit, kurse në Anatoli janë shumë). Rromët janë grupi më i madh me afër 12.000.000 në tërë Evropën, si del nga tabela "Gjuhë e popuj pa territor kompakt", e cila kallëzon tiparet e tyre kryesore.

Midis këtyre popujve pa territor kompakt, disa kanë pasur një histori të dukshme, kanë pasur veçori shumë të spikatura si dhe intelektualë, politikanë e shkrimtarë në zë e prandaj identiteti i tyre është njohur me qartësi; kësaj janë për shembull Hebrenjtë kudo në tërë Evropën e në shumë vende të botës, por edhe Samët e 3 vendeve skandinave e Rosisë veriore. Disa kanë ardhur vonë në Evropë: Armenët perendimorë e Aramejenët, që kanë ardhur kryesisht mbas gjenocidit e vitit 1915 në Devletin otoman nën sundimin e Zhën-Turqëve pro-evropianë. Prandaj edhe ata njihen me një identitet të qartë.

Mirëpo të tjerët janë pjesë të peizazhit etnik evropian që në një kohë, që e tejkalon kujtesën njerëzore. Ata në përgjithësi janë përbuzur e asnjëri nuk është interesuar për trashëgiminë e tyre kulturore, shpirtërore, letrare (flas për letërsinë sidomos gojore) etj... Duke qenë se Rromët janë më shumë, edhe ata të tjerë janë vështruar e trajtuar sikurse janë Rromët, si rimorkio e Rromëve, nën emra fyese të ndryshme. Përbuzja etnike është një shfaqje e zakonshme e budallallëkut njerëzor, i cili nuk ka shoqe më të mirë sesa mizoria njerëzore. Të dy bashkohen në sjelljen e mazhorancës për të hedhur bashkë në një kosh (të mos themi kosh i plehrave) ata njerëz të mospërfillur, ata "mbeturina njerëzore", ata "nën-njerëz" siç thoshte Hitleri. I tillë ka qenë trajtimi i përgjithshëm nën ideologjinë e racizmit, ndërsa bashkë-fshatarët e Rromëve, Egjiptianëve etj... i dallonin shumë mirë, duke ditur kush është kush, e duke i vlerësuar si fqinj, si bashkëpunëtorë, nganjëherë edhe si krushq etj... Sot me rritjen e peshës së burokracisë, dituria e fshatarëve ia la vendin mosditurisë e paragjytimeve të zyrtarëve.

Në këtë mënyrë 4 ose 5 popuj pa territor kompakt janë ngatërruar me Rromët.

Meqenëse këta popuj janë shpërndarë në zonë të ndryshme të kontinentit, pa kontakt me njëri tjetrin, pretekstet e ngatërrimit janë të ndryshme gjithmonë duke nisur si pretekst nga një e vërtet e keqinterpretuar, por arsyeja reale është e njëjtë, dmth përbuzja, mosvlerësimi e diskriminimi i këtyre popujve. Tani përbuzja e mosvlerësimi kanë kaluar një shkallë më lartë, duke qenë qëndrimi i autoriteteve ndërkombëtare, siç janë Banka botërore e CIA-ja, të cilët i hedhin bashkë në një kosh (të mos themi kosh i plehrave) ata njerëz të ashtu quajtur tashmë bashkarisht "Rromë", si shprehje politikisht korrekt në fjalë, por me konceptin e vjetër e pandryshuar përbuzës "Gypsy". Shumë kollaj të ndërrosh një fjalë, shumë vështirë të dezintegrosh një paragjykim më vështirë sesa një atom, thoshte Ajnshtajn...

Mirëpo mbas Bankës Botërore e CIA-së, ndjekin me vrap edhe shërbëtorët e tyre si OKB-ja, Këshilli i Evropës, OSBE-ja, UNESCO-ja si dhe qeveri të ndryshme, të cilat u binden atyre (sidomos Këshillit të Evropës) në pritje të ndonjë avantazh politik. Që të mos kompleksohet harta etnike e Evropës e të mos lodhen ata duke mësuar realitetin siç është në fakt, të gjithë ata sakrifikojnë të vërtetën në favor të rehatit të tyre. Ato harrojnë se dituria e vetë popujve në fjalë, si edhe ajo e qytetarëve që bashkëjetojnë prej shekujsh me këta e që përputhet me dituria shkencore, ka më shumë vlerë sesa një copë letër e nënshkruar nga disa teknokratë, që pretendojnë, si zakonisht, të vendosin për fatin e popujve. Pastaj vijon edhe OJQ-të e shitura, që kujtojnë se mund të marrin më shumë para në këtë mënyrë, duke kërcyer si i bie diktatori euro-amerikan, i cili nuk ka haber për historinë e Ballkanit, por imponon stereotipat e vet, kur, ku e si kujton se ka leverdi...

ENDONIM	EGJIPTIAN	RROM
Prejardhja	Egjypti	India (qyteti Kanauhx)
Koha e nisjes	+ 304-327 (sipas Hugh Poulton)	+ 1028
Mbërritja në Ballkan	Shekulli IV; burrat vetëm, që u martuan m vonë me gra vendase	Shekulli XIII-XIV
Lëvizjet historike	migracion në kohën e largimit nga vendi prejardhjes, pastaj sedentare	migrim historik ndaj Evropës nga Lindja në Perëndim
Lëvizja sot	0	2-3 %
Gjuha e shtëpisë	shqip ¹	rromisht
Rrënjë leksikore nga gj. e vj.	3-4 (aspi, çoçe, nok, hárai [?], tal...re)	900
Emri në shqipen e F. së Mëll	magjup, ashkali	magjup
Emri në shqipen e Dukagjini	magjup, ashkali	gabel
Emri në Shqipëri	Evgjit, Jevg	gabel, arixhi, kurbat
Emri në Maqedoni	????? , ????????	??????
Emri në Greqi	? □???????? ? , ? ?C? ?	???? ? , ????????? ? (???????? ?)
Emri në Bullgari	?????? , ??????	?????? , ????
Emri në Turqi	k>pti, k>ptiyan (çingane, çingene)	çingene (kptiler)
Emri rromisht	rlie, ?ibane, @kallie	Rroma
Numër në Evropë	250-750.000	15.000.000
Shtirirja	KS, AL, MK, GR, TK, BG	në të gjithë Evropën
Diaspora dytësore	SR, FR, UK, DE, CH, IT	përtej detit (2.400.000)
Trashëgimi muzikore	?	e konsiderueshme
Krijimtari letrare	?	në fillësë (CCCP, SFRJ, etj.)
Flamuri	(me kontroversë)	i pranuar prej 10-ra vitësh
Himni	-	Gelem, gelem
Feja	vonë e vonë të krishterë, por sot të gjithë muslimanë në Kosovë	muslimanë në përgjithësi në Kosovë e Maqedoni
Festa kryesore	Shën Naumi, Shën Athanasi	Shën Gjergji (6 maji) Bibia për ortodoksët
Vendbanimi	nëpër qytete (nganjëherë në qendër), në fshatra të veçantë	qytete (periferi), fshatra e lagje të përziera
Numri mesatar i familjeve	8 persona	6 persona për vater
Regjistrimi	të panjohur nga administrata	"grup etnik" në kohën e Titos
Shkollimi	shumë i ulët për ata të "dukshëm"	i ndryshëm
Profesione bujqësore	mjaft të shpeshta	mjaft të rralla
Profesione muzikore	pjesëmarrje mesatare	pjesëmarrje shumë e lartë
Pozicioni i farkëtarëve	në këmbë	i ulur
Përqafeshim politik në vend	deri vonë, asnjë	minimal dhe fiktiv
Përqafeshim politik në Evropë	asnjë	fiktiv
Masmedia	praktikisht asnjë	shumë por të paqëndrueshme
Pozicioni gjatë konfliktit	më shumë pro-pavarësi shqiptare	në favor të statu quos së Titos
Pjesëmarrje në UÇK	Po	Pak
Prani në letërsinë e të tjerëve	0 deri?	Mjaft deri shumë
Prani në Web	?	Mjaft

¹ Në disa zona të Maqedonisë flasin vetëm maqedonisht kurse në qytetin Madan të Bullgarisë është raportuar se kanë një zhargon të pakuptueshëm.

Të gjithët harrojnë një fakt: kurdoherë në histori, kur është mbuluar një e vërtetë me petkun e përrallave zyrtare, ajo ka vepruar si bombë me shpërthim të vonuar e nuk dihet çfarë pasoje mund të ketë në këtë rast. Prandaj, këshilli im është të mbetemi sa më afër së vërtetës e kështu do të mënjanojmë pasoje të padëshirueshme më vonë, në situatë krize apo lufte, kush e di... Por është edhe e njohur se koha e politikës tradicionale është, për arsye elektorale, dritëshkurtër. Po sikur ndihmesa e parë e politikanëve egjiptianë, mësimi i tyre i parë për Evropën, të ishte ta ndërrojnë këtë optikë dritëshkurtër në një politikë largpamje?

Këtu na intereson konfuzioni midis Rromëve e Egjiptianëve, por para se t'a analizojmë në perspektivën historike, le të shikojmë, një nga një, diferencat kryesore midis të dy komuniteteve me tabelën përmbledhëse të paraqitur në faqën paraprake.

Shihet se dallimi midis këtyre popujve është mjaft i qartë për atë që do t'i kushtojë sado pak vëmendje. Megjithatë dëgjojmë ende të pohohen publikisht të pavërteta të tipit "Ashkalinjtë flasin rromisht në shtëpi" (një kineast serb në janar 2001), gabim që vjen jo nga vëzhgimi personal i injorantit në fjalë por nga leximi i një veprë të njohur për pasaktësinë e saj "Romi u Jugoslaviji" Tatomira Vukanoviæa (1983).

Aneksionizmi rrom, servilizmi egjiptian shkaqet

Jo vetëm Banka botërore e CIA-ja ngatërrojnë këta dy popuj nga nënvlerësimi i tyre, por edhe disa udhëheqës rromë, të cilët e dinë fare mirë nga përvoja e tyre e lagjes kush është Rrom e kush është Egjiptian, por miratojnë këtë ngatërrim, sepse natyrisht e kanë më kollaj për karrierën e vet të ndjekin atë që thonë të fuqishmit fond-dhënësë e sepse janë ende të obseduar nga kuotat (kanë mbetur mentalisht te sistemi i vjetër ἰῆσὶό), që në kohën e Titos lejonin ngritjen sociale kolektive sipas përqindjes së kombeve e kombësive në popullsi, por gjithashtu hapnin shteg manipulimeve të shumta. Më kanë treguar pa pikë turpi si mbledhin Egjiptianët para aplikimit për subvencione në emër të unitetit e pastaj, kur vjen subvencioni, si i dëbojnë duke thënë se ata nuk janë Rromë. Përveç fondeve, disa kanë edhe hallin e bazës elektorale: në qoftë se kontingjenti i zgjedhësve egjiptianë potencialë shkëputen nga trupi rrom, kandidatët bien në panik sepse kështu rrezikohet karriera e tyre. Natyrisht ata mund të mbulojnë si popullsi rrome po ashtu edhe atë egjiptiane, sepse politika (në parim) nuk ka për detyrë të merret me histori apo etnologji, duhet të merret me vlerat e ndërtimitin e demokracisë, që janë: kushte korrekte e jetesës për të gjithë, dinjiteti i secilit/secilës, liria e zhvillimit personal e kolektiv, harmoni në shoqëri etj. (lista është tepër e njohur) për rromët, për egjiptianët e për të tjerët. Por më duket se kandidatët pak i intereson kjo, strategjia politike "për të fituar" ka prioritet absolut e prandaj shoh me keqardhje se kanë bojkotuar këtë tubim. Në qoftë se nuk janë në gjendje të dallojnë dimensionin historiko-etnik nga ndërtimi politik i shoqërisë, kjo më shqetëson sepse më duket shumë e rrezikshme. Është për mendimin tim edhe një qëndrim i turpshëm por dua të them se nuk kanë faj tërësisht: vetë sistemi klientelist e kërkon, vetë sistemi çon në korrupsion. Një qëndrim po ashtu jo shumë i denjë është ai i disa egjiptianëve, të cilët në shtëpi mbahen si të tillë (ose Ashkalinj), por deklarohen si Rromët në qoftë se i pyet ndonjë zyrtar, sidomos një Euro-zyrtar, i cili kush e di ndoshta ka ndonjë ndihmë humanitare ose subvencion në mëngë... e aq më tepër si zyrtari në fjalë (ose përkthyesi i tij/saj) u shtron pyetjen atyre me një ton më tepër pohues sesa pyetës... Zyrtari në fjalë do të kthehet në qendër me bindjen tepër naive që "vetë me kanë thënë egjiptianë se janë rromë" e ngatërrimi forcohet në nivelin më të lartë.

Mirëpo çdo gënjeshtër ka një element të vërtetë, një bazë, sepse për ndryshe nuk mund të besohet dot mbasi gënjeshttrat farkohen që të besohen, jo kot ose për sport. Edhe ngatërrimi midis Egjiptianëve e Rromëve ka një bazë bile pesë bazë të rreme, të mbështetura në gabime, e këto baza dëshiroj t'jua paraqes tani pak nga ana historike.

Tani ju propozoj një minutë refleksioni: a nuk ju duket e çuditshme që të zhytemi në të kaluarën më shumë se një mijëvjeçar e gjysmë për të shpjeguar dukuri të tanishme? Është sikur të themi se arritja e Hunëve në fushën e Panonisë ka ndonjë rëndësi sot. Dihet se disa njerëz në Hungari bëjnë përpjekje për njohjen e minoritetit hun, i cili ka afro 4.000 anëtarë. Pse kjo është absurd në Hungari për Hunët e mund të jetë kuptimplotë për Egjiptianët në Ballkan. Arsyeja është shumë e qartë: jo vetëm nuk ekziston asnjë etnomarker për Hunët në Evropën qendrore, por edhe ata nuk kanë pësuar e nuk pësojnë sot ndonjë dallim, qoftë pozitiv qoftë negativ, thjesht janë zhdukur nga peizazhi etnik i zonës, janë shkrirë totalisht, kurse Egjiptianët në Ballkan nuk janë shkrirë në masën e popullsisë, mazhoranca i dallon dhe shpeshherë (jo gjithmonë por mjaft shpesh) i përbuz e i diskriminon. Është krijuar prej tyre një fare kaste, ndoshta që në mbërritjen e tyre në Ballkan e ky imazh negativ ripërsëritet brez pas brezi: "integrimi" i tyre ka dështuar atëherë e ndasitë e krijuara ashtu po ripërsëritet. Një gjë e tillë ka ndodhur me Samët në Skandinavi: kur Finët e Gjermanët kanë mbërritur atje, i kanë gjetur Samët si popullsi vendëse e i kanë përjashtuar nga shoqëria e tyre. Ky përjashtim ka vazhduar të paktën deri Lufta e parë botërore, me mjaft përndjekje të ngjashme me një gjenocid... Siç del në pah nga historia, kur integrimi i ndërsjellët nuk bëhet që në fillim, kur të dy popullsitë hyjnë në kontakt (zakonisht kur të dy janë me numër të lartë), atëherë krijohet një frakturë, një ndasi e cila vendoset në shoqërinë e mund të vazhdojë shekuj o mijëvjeçarë me radhë. Politika për ta eliminuar është atëherë jashtëzakonisht delikate.

Është e vërtetë se këta popuj kanë vuajtur mjaft gjatë historisë së tyre tragjike, por nga ana tjetër kanë mbajtur e kultivuar një kulturë të mrekullueshme. Përveç kësaj, një tipar i veçantë i dallon nga kombet që kanë krijuar një shtet: ata të fundit e shohin identitetin e tyre kryesisht nëpërmjet shtetit, me strukturën standarde të tillë e të njëjtë pak a shumë në të gjithë botën, për të gjithët kombe-shtete, kurse ata e ndjejnë identitetin e tyre secili në një mënyrë tjetër, kush më shumë në lidhje me gjuhën, kush me kishën, kish me ndonjë element tjetër. Kanë një lakueshmëri e një larmi perceptimesh me shumë vlerë për të relativizuar pamjen e ngultë të nacionalistëve në këtë fushë e kjo është një model origjinal, një mësim i fuqishëm e një kontribut ideore me vlerë për të liruar sadopak tensionin e krijuar nga tendosja e identiteteve në Evropën e sotme.

Demokracia nuk lejon të lëndohet një segment i qytetarëve, aq më tepër kur nuk ka as arsye as pretekst (si për shembull ndonjë hakmarrje pas ngjarjeve luftarë), prandaj, për sa i përket Ballkanin, duhet pranuar fakti që ekziston ende sot një ndasi midis mazhorancës e Egjiptianëve mbyllja e syve do të ishte një miratim i heshtur i situatës së tyre. Vërtetë ata jetojnë si Shqiptarë, ata kanë themeluar fise shqiptare me mbiemra shqiptarë. Megjithatë, ndërsa në nivelin e miqësisë apo të fqinjësisë individuale ose familjare nuk hasin në shoqëri ndonjë vështirësi të veçantë, vetë përmendja e identitetit të tyre (zakonisht si magjup ose si ashkali) krijon a priori një distancë jo të favorshme ndaj tyre, me pasojë të rënda në punësim, në administratë, në shkollim etj. Mund të ndajmë si më poshtë situatat kryesore e reagimit të mazhorancës sipas tyre:

A	Kontakt direkt i përditshëm midis familjeve egjiptianë dhe mazhorancës (fqinjë, miq, bashkëpunëtorë etj...)	bashkëjetesë normale, por me ndonjë distancë (që s'mban shumë) në rast konflikti, njësoj si midis fisave shqiptarë
B	Përmendja e personit "Magjup/Ashkali" si i tillë	shumë paragjykime, me pasojë shkatërruese
C	Kontakti i parë me një egjiptian(e) të panjohur e që mund të identifikohet ose nga pamja, ose nga thashethemet	reagim me shumë kujdes, i kushtëzuar nga B (më lartë), por që mund të ndryshojë më vonë (me shumë përpjekje nga ana e egjiptianëve)

Në momentin kur po mbaroj hartimin e këtij teksti, disa shokë më lajmërojnë se u mbush face-booku me fyerje e kërcënime kundër meje si pasojë e kumtesës sime. Mund të them vetëm një gjë: ka 40 vjet që u binda, nga vetë rrëfimet e egjiptianëve të atëhershëm, se ata nuk janë rromë, gjë që u konfirmua më vonë, e nuk do ta kthej kazakën tani pa arsye tjetër se zemërimi i disa karrieristëve.

Një ndasi e tillë vihet re edhe në Indi, ku para 3000 viteve, një pjesë e autoktonëve të truallit indian hyri në sistemin varnik të prurë nga Arianët e a rdhur nga Azia qendrore. Kjo pjesë përbëri varnen e katërt (shudrat) të sistemit, kurse pjesa tjetër mbeti jashtë atij sistemi e njihet sot si aea??ala ose dalitë (për të thjeshtësuar, pak a shumë "të paprekshmit").

Prandaj, detyra e demokracisë është nga një anë të luftojë kundër diskriminimit të rrënjosur ndër shekujt e nga ana tjetër t'i sigurojë asaj kulture jo vetëm mirëmbajtje por edhe pasurim e zhvillim në harmoni të plotë.

Rrjedhimisht, duhet gërmuar edhe më thellë, duhet kërkuar origjina e situatës së arritur e është pikërisht ajo që po bëjmë ne në këtë tubim, duke identifikuar elementet e historisë së Egjiptianëve për të vënë në pah se nuk përbëjnë ndonjë pengesë në funksionimin e shoqërisë, por përkundrazi sjellin një trashëgimi kulturore me vlerë e me interes për tërësinë e saj.

Disa situata që janë shfaqur para shekujsh kanë pasojë deri më sot, njësoj si një njëri që vdes e lë mbas tij nganjëherë për disa breza me radhë ngatërresa në familje.

Mund të dallojmë 5 fazë:

1. Fajin e kanë elefantët

Faza e parë lidhet me interpretimin e gabuar të tokës nga gjeografët e lashtësisë. Pierre Schneider ka kushtuar një libër të tërë (L'Éthiopie et l'Inde, Romë 2004) ngatërimit të tyre midis Indisë e Etiopisë (Jugu i Egjiptit) duke shkruar: "Në organizimin e botës së banuar, Grekërit e Romakët përcaktin larg në lindje e në jug popuj që quanin Indianë e Etiopianë por, siç e tregojnë gjerësisht burimet e lashta, India e Etiopia e paraqitjeve (përfytyrimeve) të lashta shtyheshin ndaj njëra tjetrës nën ndikimin e një tërheqjeje të fuqishme. Përcaktimi i hapësirave, konceptimet gjeografike, mitologjia, historia, fauna, flora [... kanë krijuar interferencë të fuqishme, që...] nuk janë zhdukur në Perëndimin mesjetar. Manifestim spontan e autentik i shpirtit greko-romak, ngatërresa e Indisë me Etiopinë na lejon të kuptojmë më mirë si, në lashtësi, përfytyroheshin zakonisht hapësirat e largëta, tokësore apo detare, njeriu zezak, fauna ekzotike, për të përmendur vetëm disa aspekte. Kjo dukuri nuk përkufizon thjesht mangësitë e njohurive të lashtë, por përkundrazi na jep një rast të afrohem me njeriun e Lashtësisë duke na e bërë atë më të afërt". Me një fjalë ata e shihnin botën si një disk i shtrirë midis zonave jugore me popullsi shumë të zeza zezakët, e zonave veriore me popullsi shumë të bardha, bardhakët e në mes popullsi esmere nga Lindja e mesme e deri në Ballkan të mos harrojmë se Ballkanasët e lashtë ishin mjaft esmerë e u zbardhen më vonë me mbërritjen e ilirëve, grekëve e sllavëve të paktën nëqoftëse ndjekim rezultatet e hulumtimeve të Profesores lituano-amerikane Maria Gumbutas, e cila konsiderohet në nivelin botëror si referenca më e besueshme në këtë fushë.

Temës së gabimeve të gjeografëve së Lashtësisë e pasojave të tyre deri më sot, i kam kushtuar një kumtesë në korrik 2013 në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë e do të përdor tani hartat që ilustronin këtë përfytyrim, por të mos harrojmë se në lashtësi nuk kishte hartë gjeografike, koncepti nuk ekzistonte, e kur flasim për hartës e Ptolemesë për shembull, duhet ditur se është një hartë e vizatuar në Mesjetë në bazë të përshkrimeve e koordinatëve e Ptolemesë, jo një hartë që paskishte vizatuar ai vetë.

Kjo pjesë këtu është pak e gjatë, besoj se do të më falni, por besoj se ka mjaft rëndësi dhe do të citoj edhe një autor tjetër, Giovanni di Plano Carpini: "Jourdain de Séverac [përdor] këtë sërë tjetër emrash: India minora, India Majora, India tertia, të cilat në planisferën e Martino Sanudos riprodhohen me pak diferencë, ashtu si vijon: India parva quæ est Ethiopia, India magna, India interior Joannis presbyteri".

Libri i Pierre Schneiderit është jashtëzakonisht me interes për Ju por duhet të shtoj këtu edhe një aspekt tjetër, i cili del nga klasifikimi i fiseve njerëzore në Bibël në tre megagrupe: përkatësisht pasardhësit e të tre të bijve të Nuhisë (ose Noas, ose Nojës) ndahen në ata të Hamit zezakët, të Jafetit bardhakët dhe Semitët një popullsi pak a shumë esmere. Prandaj nuk është për të çuditur që, kur ata gjeografë kanë reflektuar mbi strukturën e tokës e cila për mendimin e tyre ishte rrafsh, si një disk ose një pizza, e kanë parë me :

- nga veriu, me ftohtësi sa herë më të madhe sa ecësh ndaj veriut, një kontinent të bardhë të banuar me fisin e Jafetit Evropë, në veri të Mesdheut.

Mirëpo është plotësisht e logjikshme që të kenë ekstrapoluar me

- nga jugu, me vapë sa herë më të madhe sa ecësh ndaj jugut, një kontinent të zezë të populluar me fisin e Hamit, në jug të një deti imagjinar, që e kanë quar Prasodis Mare. E kishin të qartë se në jug të atij deti imagjinar, India bashkohej me Etiopinë, dmth me jugun e Egjiptit, mbasi njerëzit ishin të zinj e nga të dy anë kishte elefantë...

2. Indianët e Malik Shahut bëhen egjiptianë

Edhe këtu kemi të bëjmë me një fakt të vërtetë që u interpretohet në një mënyrë të gabuar. Kur rreth vitin 1060 mbërritën në Anadulli lindore turqit e parë nën komandimin e Arp Arslanit nga fisi Selxhuk, ata ishin bashkë me mjaft Persë të Horasanit e me gulamët (skllëvrit) e tyre indianë me gjasë proto-Rromët. Në vitin 1071 morën qytetin e Manzikertit nga Bizanca e filluan të dëpërtojnë në Anadulli, ku nuk kishte Turq deri atëherë, por vetëm Grekë, Armenë, Osetë (ose Alanë), Kurdë, Gruzianë, Siriakë, pak Koptë e Arabë, si dhe popullsi sot të zhdukura. Dy vit më vonë një kontingjent i tyre, të komanduar nga Malik Shahu, hyri në Jeruzalem, i cili ishte brenda kufinjve të shtetit shi'it fatimid egjiptian. Në 1098, ushtria egyptiane e rimori Jerusalemin duke dëbuar turqit selxhukidë, POR indianët e persët, të cilit kishin një funksion më tepër logjistik, mbetën atje. Kur më 15 korrik 1099 kryqtarët morën Jerusalemin nga duart e Fatimidëve, ata masakruan deri në një tërësinë e njerëzve në qytetin e shënjtë, duke natyrisht kujtuar se indianët ishin egjiptianë të mirëfilltë. Në këtë mënyrë, indianë proto-Rromë morën etiketën e Egjiptianëve me rastin e betejës e plojes së Jeruzalemit e ky emër u shpërnda si famë një të gjithë Lindjen e afërt. Nga kontakti me armenët, rromët kishin fituar edhe një llogaritje tjetër, atsinganë (heretikë), i cili ishte një fyerje fetare e rëndë në gojën e bizantinasve. Mirëpo, ata kishin më shumë leverdi me emrin "Egjiptianë" sesa me një fyerje fetare, aq më tepër se afroreshin me zonat e jugut e të perëndimit të Anadollisë, ku kishte më shumë grekë e më pak armenë. Prandaj ata vetë kanë preferuar e fuqizuar shekuj me radhë emrin Egjiptianë.

3. Sistemi i milleteve

Selxhukët, të cilit kishin ardhur në Anadulli bashkë me proto-Rromët e me Persët e Horasanit dinin shumë mirë, kush ishin Rromët por siç dihet (e në kllapë siç mund ta ndjekin në telenovelën televizive Dilirip Ertudrul), devleti i tyre ra e u ngrit devleti osman, me në krye Osmani I, i cili ishte nga veri-përendemi i Anadollisë, nuk kishte kontakt me rromët e jugut të vendit dhe administrata e tij filloi t'i ngatërronte me Egjiptianë, mbasi vetë ata paraqiteshin si egjiptianë karshi grekëve. Kur në vitin 1453 Mehmed II krijoi sistemin e milleteve, u ndanë rromët në dy millet: millet-i rum për të krishterët (midis 60% e 75% sipas zonës e kohës) e millet-i suna për myslimanët, ndërsa egjiptianët e koptët u mblodhën me armenët në milletin armen. Në fakt koptët janë një kishë egjiptiane, e cila pësoi përndjekjet e bizantinasve e pastaj të myslimanëve në një mënyrë të ngjashme si paraardhësit tuaj kanë pësuar ata të romakëve.

Mirëpo, kemi të bëjmë këtu me ngatërrimin e tretë, që duket nga konfuzioni termave çingene (< ἀεβίααἰῖδ), kÿpti e kÿptiyan (< [ἀέ]ἄγδδῖδ, njësoj si "kopt").



Fig. 2

4. Konfuzioni i katërt ose mospërfillës-oportunist

Konfuzioni i katërtë u krijua në shkrimet evropiane, të cilët, nga përbuzja e tyre ndaj popujt egjiptianë e rromë, e kanë lënë bajat shumë shekuj këtë fushë të shkencave historike. Më kujtohet një profesor në Sorbonë, profesori Stroma (i ati), i cili, kur dëgjoi fjalën "romologji", u habit: "Si? Paska një shkencë për këta njerëz? A mund vallë të mësojmë diçk prej tyre???"

Kur një intelektual në zë flet kështu, çka mund të presim nga një administrator??

5. Konfuzioni i pestë ose "politikisht korrekt"

Edhe kjo ndahet në tre nën-konfuzione:

a) ai i autoriteteve si Banka botërore ose CIA me shërbëtorët e tyre. Për këtë kemi folur.

b) ai i disa OJQ-ve rrome të cila e mbështesin këtë qëndrim për të parë një bazë statistike më të gjerë, për të siguruar fonde nga të cilët pastaj përjashtojnë egjiptianë si jo-romë e sidomos për të ndjekur në mënyrë servile diktatin e të fuqishmëve

c) ai i kishave evangjeliste, mjaft të finansuara nga shteti israelian e të cilat duan të bëjnë nga Rromët një fis të humbur të Israelit, që në kohën e skllavërisë në Egjipt e kërkokan me një fantazi të paparë hije argumentash ku të jenë për ta vërtetuar këtë, për sh. nga emri i Sarasë, nxjerrin se ajo ka qenë nëna e të gjithë Rromëve në botë etj... Niveli i argumentimit është kaq i ulët që ka interes më tepër për studimet në fushën e mungesave në pedagogji; megjithatë ata helmojnë diskutimin me të vërtet shkencor.

Si konkluzion mund të themi se puna për të bërë është shumë e vështirë, jo kaq shumë për të kuptuar mekanizmat e së kaluarës, por për të informuar opinionin publik e, ende më vështirë, autoritetet e installuara. Nëqoftëse përveç kësaj, na vijnë e na tregojnë se historia është kot e nuk na duhen shkencat historike, mund të imagjinojmë në çfarë qorrësokak jemi futur.

Prandaj është një mrekulli që jeni këtu, të vetëdijshëm për identitetin tuaj e rezistuese si partizanë kundër trillimeve të injorantëve.

Dy fjalë për Ashkalinjtë

Tani shtrohet edhe çështja e Ashkalive. Para 40 viteve, as nuk imagjinohej se në vatrat e Egjiptianëve ndonjë lidhje me Egjiptin. Ata identifikoheshin si Ashkali duke theksuar se nuk janë rromë, vetëm jetojnë shpesh, por jo gjithmonë, në të njëjtat zona urbane. Kur pyeteshin nga kanë ardhur, pleqtë e tyre kishin një shprehje: "Kena ardh' pe Misiri, q'është një shehir n'Turqeli" e më kujtohet se me njëfarë naiviteti, kemi kërkuar natyrisht pa sukses ku ndodhet qyteti Misiri në hartën e Turqisë së atëhershme. Më vonë kuptuam se Misiri është Egjipti, i cili faktikisht ndodhej brenda "Turqelisë" dmth. Devletit Otoman, e jo në ndonjë "shehir" por një vendi i tërë. Me zbulimin e origjinës egjiptiane të tyre nga i ati i Rubinit me shokë, grupi i tij intelektual vendosi të hedhë poshtë emrin "Ashkali" për ta zëvendësuar me "Egjiptas" a më vonë "Egjiptian", duke konsideruar se "Ashkali" është përbuzës (pak a shumë si Titoja kishte dhënë urdhër të zëvendësohej "Öëääîêî" me "Đî" me rrezik gjobitjeje). Kështu u shfaq në skenën jugosllave komuniteti egjiptian, ndërsa ata Ashkalinj, që nuk pranuan ndërrimin e emrit "Ashkali" në "Egjiptian" duke qenë se nuk e konsideronin atë fjalë si përbuzëse, ngritën shoqatën e Ashkalinjve, megjithëse në thelb ata janë i njëjti komunitet. Ardhja e ndërkombëtarëve, të cilët në bazë të një vëzhgimi të përciptë, vendosën që do të ekzistojë vetëm një komunitet e që ai do të quhet RAE pruri vetëm më shumë ngatërrim në një çështje, e cila në fund të fundit është mjaft e thjeshtë me kusht që të analizohet pa paragjykime.

Si konkluzion çfarë mund të themi ? Ja disa propozime:

1. të ngrini kudo identitetin tuaj e ta përdorni për të hapur mendjen e mazhorancës për vlerat e Egjiptit, qoftë Egjiptit të lashtë, qoftë atij të Ptolemeve, qoftë atij të krishterëve etj. Europa ka ngritur kulturën greko-latine në kohën e Rilindjes. Evropa ka nevojë tani për një Rilindje tjetër, se është kalbur deri në thelb. Pse to mos jeni ju ata që mund të sillni dritë nga egjiptologji, një shkencë që ka mijëra hulumtues entuziastë në gjithë botën, deri në Japoni ? Por një shkencë që ende nuk ka hyrë nëpër shkollat. Pse të mos tregoni një dimension tjetër të kulturës evropiane, atë të rrënjëve të saj në Egjipt ? Përveç kësaj, çdo etap i historisë suaj është një mësim në fushën e politikës, të trajtimit të feve (mos harroni se faraoni Amenofisi i IV, (më vonë Akhen-Aton "shërbëtori i diskut qiellor", ka krijuar konceptin e monoteizmit, jo hebrejtë, të krishterët ose muslimanët), të administrimit të shoqërisë, të arkitekturës, letërsisë, tregtisë në Mesdheun etj.

2. Për rininë, është mirë të bëhen lodra elektronike për ta thithur në veprimtari intelektuale lidhur me identitetin tuaj e më vonë me shkenca historike e egjiptologjike, që me të vërtetë janë pasionante e mund të shpëtojnë të rinjtë e të rehat nga rruga e keqe që shtrohet fatkeqësisht para tyre sidomos nëpërmjet internetit. Edhe kjo ka një rezultat tjetër: do të tregojë opinionit të gjerë kumtesën shpirtërore e materiale që ka sjellë në botë Egjipti, edhe pse, nga mungesa dokumentesh, është vështirë të përcaktohet hollësisht çfarë ndihmesë ju keni prurë në kulturën ballkanike ma merr mendja një ndihmesë jo e vogël, si për sh. e midis të tjerash në krishterizimin e gadishullit.

3. Edhe një punë tjetër mund t'i besohet rinisë: të përgatisë një dokumentacion të mirë për internetin, duke filluar nga Wikipedia shqip e deri te webin për popuj pa territor kompakt ubibene. Jam në dispozicionin tuaj për t'ju ndihmuar me sa kam mundësi... sidomos për gjuhët e tjera.

4. Të mblidheni përtej kufirit për të shkruar një manifest të përbashkët me elemente faktike historike, kush jeni e kush nuk jeni, e ta paraqisni pranë autoriteteve botërore (a më vonë evropiane, duke ditur se ato janë kundër) duke kërkuar njohjen e identitetit tuaj si identitet socio-historike e përfaqësinë tuaj pranë tyre.

5. Të tregoni se amalgami i Rromëve me ju e me disa popuj të tjerë pa territor kompakt është krijuar jo nga ju, jo nga faktet e historisë, por nga gabimet e lashtësisë e nga mospërfillja e vetë diskriminuesve, prandaj në asnjë mënyrë nuk është e drejtë të përdoret si bazë për politikë as ndaj jush, as ndaj të tjerëve.

6. të vazhdoni të luftoni për barazi të plotë në fushën e respektit e të drejtave e detyre të popullit tuaj me të tjerët, të vazhdoni në mbrojtjen e tyre edhe për Rromët e popujt e tjerë pa territor kompakt e pastaj për minoritetet e tjera, si për të gjithë grupet e individët të shtypur ose të trajtuar në mënyrë të padrejtë, me një fjalë për një jetë më të mirë për të gjithë në një botë të bazuar në respekt: nga respekti i më të voglit deri te respekti i natyrës.

Një gabim shumë i madh do të ishte ngatërrimi i identitetit historiko-kulturor me veprimet socio-politike. Në fushën e identitetit historiko-kulturor Rromët e Egjiptianë, siç a kemi treguar, nuk kanë asnjë gjë të përbashkët: janë vetëm injoranca në lashtësi, mospërfillja me vonë e manipulimet politike tani, nën petkun hipokrit të humanizmit fallso, që i kanë bashkuar, kurse në fushën socio-politike duhet unitet veprimi, solidaritet të plotë me popujt e tjerë pa territor kompakt në radhë të parë (mos harroni se gati të gjithë këta popuj kanë pësuar një gjenocid në shekullin XX) e me çdo njëri apo komunitet tjetër në nevojë më vonë për sigurimin e konsolidimin e drejtësisë, e cila është nëna e paqes në rajonin, në Evropë e kudo në botë.